

**Kuvendi i Shqipërisë, në seancën plenare të datës 28 maj 2020, miratoi emërimin e Z. Ervin Mete në detyrën e anëtarit të Bordit të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, që do të mbajë funksionin e Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv**

### Vështrim mbi tregjet

- Zhvillimet e Tregut të Sigurimeve në Shqipëri për periudhën janar-prill 2020

### Zhvillime të tjera

- Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv i AMF-së zhvillon një takim online me Drejtuesen e re të Misionit të FMN-së për Shqipërinë
- Miratohet projektligji “Për Tregjet e Kapitalit”
- Miratohet projektligji “Për tregjet financiare të bazuara në teknologjinë e regjistrave të shpërndarë”

### Publikime Ndërkombëtare

- Global Risk Regulator
- Financial Times

### Lajme Ndërkombëtare

- EIOPA
- Evropa Qendrore dhe Lindore
- Serbi

Mbrojmë Konsumatorët - Promovojmë Tregjet - Zbatojmë Ligjin

**Kuvendi i Shqipërisë, në seancën plenare të datës 28 maj 2020, miratoi emërimin e Z. Ervin Mete në detyrën e anëtarit të Bordit të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, që do të mbajë funksionin e Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv**



*Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, Z. Ervin Mete gjatë takimit me Drejtuesen e re të misionit të FMN-së për Shqipërinë, Znj. Yan Sun*

**Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv i AMF-së zhvillon një takim online me Drejtuesen e re të Misionit të FMN-së për Shqipërinë**

Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, Z. Ervin Mete, zhvilloi një takim me Drejtuesen e re të misionit të Fondit Monetar Ndërkombëtar për Shqipërinë, Znj. Yan Sun, përmes platformës virtuale të komunikimit Webex.

Në takim u diskutua në lidhje me zhvillimet më të fundit në tregjet nën mbikëqyrjen e Autoritetit dhe zbatimin e pandemisë COVID-19. Z. Mete u shpreh se tregu i sigurimeve rezultoi më i ekspozuari nga efektet e koronavirusit, edhe pse pritet që rihapja të sjellë normalizimin e treguesve financiarë për shoqëritë e sigurimit.

Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv i AMF-së theksoi se miratimi së fundmi i tre ligjeve të reja nga Kuvendi i Shqipërisë, “Për sipërmarrjet e investimeve kolektive”, “Për tregjet e kapitalit” dhe “Për tregjet financiare”, bazuar në teknologjinë e regjistrave të shpërndarë” pritet të modernizojë funksionimin e këtyre tregjeve dhe të kontribuojë në zhvillimin ekonomik të vendit.

Z. Mete e cilësoi dixhitalizimin si një sfidë kryesore të Autoritetit në kushtet e reja të krijuara si pasojë e COVID-19, për të siguruar raportimin në kohë reale të të dhënave për të gjitha subjektet nën mbikëqyrje, por edhe në funksion të komunikimit ndërinstitucional dhe lehtësimit të procedurave për qytetarët.

Drejtuesja e misionit të Fondit Monetar Ndërkombëtar, Znj. Yan Sun vlerësoi rolin e AMF-së në mbikëqyrjen e tregjeve financiare jobankare, si edhe shprehu gadishmërinë për të vijuar asistencën për Autoritetin, përmes ekspertizës, edhe në kuadër të ligjeve të reja të miratuara së fundmi.

—○○○—  
Në takim u diskutua në lidhje me zhvillimet më të fundit në tregjet nën mbikëqyrjen e Autoritetit dhe zbatimin e pandemisë COVID-19.  
—○○○—

# VËSHTRIM MBI TREGJET

## Zhvillimet e Tregut të Sigurimeve në Shqipëri, janar-prill 2020


Të ardhurat nga primet e shkruara bruto të sigurimit për periudhën janar-prill 2020 kapën vlerën mbi 4,724 milionë lekë, ose 10.87% më pak se në periudhën janar-prill 2019. Gjatë periudhës janar-prill 2020, numri i kontratave të sigurimit të lidhura arriti në 284,338 me një ulje prej 24.52% krahasuar me periudhën janar-prill 2019.

Tregu vazhdoi të mbetet sërish i orientuar tek sigurimet e Jo-Jetës, të cilat sollën 93.09 % të vëllimit të përgjithshëm të primeve, duke i lënë përkatësisht sigurimet e Jetës me 6.91%. Parë nga këndvështrimi i ndarjes së tregut sipas llojit të sigurimit, i detyrueshëm dhe vullnetar, primet e shkruara bruto të sigurimit vullnetar zënë 43.97% dhe primet e shkruara bruto të sigurimit të detyrueshëm zënë 56.03% të totalit të tregut.

Gjatë periudhës janar-prill 2020, dëmet e paguara bruto në tregun e sigurimeve, arritën në rreth 2,936 milionë lekë, ose 51.32% më shumë se në periudhën janar-prill 2019.

Të ardhurat nga primet e shkruara bruto të sigurimit për periudhën janar-prill 2020 kapën vlerën mbi 4,724 milionë lekë, ose 10.87% më pak se në periudhën janar-prill 2019.

### Struktura e tregut të sigurimeve, janar-prill 2020 (Në %)



## Miratohet projektligji “Për Tregjet e Kapitalit”

Kuvendi miratoi në 14 maj , në seancë plenare, projektligjin “Për Tregjet e Kapitalit”. Projektligji përmirëson kuadrin aktual ligjor dhe i përgjigjet dinamikës së zhvillimit të tregjeve të kapitalit në vend.

Kuvendi miratoi në 14 maj , në seancë plenare, projektligjin “Për Tregjet e Kapitalit”. Projektligji përmirëson kuadrin aktual ligjor dhe i përgjigjet dinamikës së zhvillimit të tregjeve të kapitalit në vend. Ai synon nxitjen e zhvillimit dhe integritetit të tregjeve të kapitalit, rritjen e transparencës dhe mbrojtjen e investitorit përmes vendosjes së standardeve më të larta. Hartimi i ligjit të ri u realizua me mbështetjen e ekspertëve të Bankës Botërore, si pjesë e Projektit “Forcimi i kapaciteteve mbikëqyrëse të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare: Fokusi tek zhvillimi i tregut të kapitaleve”.

Projektligji është në përputhje me:

- Direktivën për Tregjet e Instrumenteve Financiare (MIFID II) si dhe rregullore të tjera të Bashkimit Evropian në fushën e tregjeve të kapitalit;
- Parimet e Organizatës Ndërkombëtare të Komisioneve të Letrave me Vlerë (IOSCO) dhe me udhëzimet e Autoritetit Evropian të Letrave me Vlerë dhe Tregjeve (ESMA).

Objektivat kryesore të projektligjit janë:

- Mbrojtja e interesave të investitorëve, nëpërmjet vendosjes së standardeve më të larta apo klasifikimit të tyre në investitorë profesionistë, investitorë të kualifikuar, palë e pranueshme apo investitorë jo profesionistë;
- Vendosja e kërkesave më strikte për licencimin, rregullimin dhe mbikëqyrjen e shoqërive komisionere dhe operatorëve të tjerë të tregut të kapitaleve;
- Nxitja e investimeve të huaja përmes afrimit të shoqërive të huaja komisionere për të vepruar në tregun vendas të kapitaleve;
- Vendosja e rregullave për mirëfunksionimin e tregut, përfshirë dhe Bursën;
- Njohja dhe rregullimi i veprimtarisë së platformave të tjera të tregtimit, duke nxitur njëkohësisht konkurrueshmërinë ndërmjet tyre;
- Krijimi dhe rregullimi i veprimtarisë së institucioneve me rëndësi në infrastrukturën e tregut, siç janë Depozitari Qendror i Titujve apo Shtëpia e Klerimit;
- Nxitja e integritetit të tregut nëpërmjet rritjes së kërkesave për transparencë për emetuesit dhe shoqëritë e listuara, si dhe për operatorët dhe institucionet e tregut.

Ligji i ri parashikon edhe rritjen e kompetencave të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare për të kryer hetime në funksion të forcimit të kuadrit mbikëqyrës dhe rregullator të tij.

## Miratohet projektligji “Për tregjet financiare të bazuara në teknologjinë e regjistrave të shpërndarë”

Kuvendi miratoi me datë 21 maj 2020, në seancë plenare, projektligjin “Për tregjet financiare të bazuara në teknologjinë e regjistrave të shpërndarë”. Projektligji synon të rregullojë infrastrukturën mbi bazën e së cilës funksionon teknologjia e regjistrave të shpërndarë “Distributed Ledger Technology” (DLT).

Projektligji rregullon kushtet për licencimin, ushtrimin e aktivitetit të operatorëve dhe bursave, si edhe mbikëqyrjen e tyre. Ai gjithashtu rregullon kushtet për emetimin dhe tregtimin e tokenëve digjitalë dhe monedhave virtuale dhe autorizimin nga autoritetet kompetente.

Nëpërmjet vënies nën mbikëqyrje të teknologjisë së re, projektligji synon:

- Shfrytëzimin e potencialit të Fintech dhe të teknologjisë DLT;
- Uljen potenciale të kostove të sistemit të pagesave;
- Nxitjen e financimeve për ekonominë vendase nëpërmjet burimeve alternative të financimit;
- Tërheqjen e investitorëve të huaj;
- Krijimin e përfitimeve ekonomike për vendin.

Pas miratimit dhe botimit në fletoren zyrtare, ligji hyn në fuqi më 1 shtator 2020.

—○○○—  
Kuvendi miratoi me datë 21 maj 2020, në seancë plenare, projektligjin “Për tregjet financiare të bazuara në teknologjinë e regjistrave të shpërndarë”.



### **Global Risk Regulator**

Covid 19: Strategjitë e daljes dhe zbatimet e tyre praktike

*(Covid-19: exit strategies and their practical implications)*

**<https://www.globalriskregulator.com/Subjects/Reporting-and-Governance/Covid-19-exit-strategies-and-their-practical-implications>**

Normaliteti i ri post Covid-19 mund ti bëjë bankat të rimendojnë masat mbrojtëse dhe treguesit e fleksibilitetit

*(Post-Covid-19 new normal could see banks having to rethink resilience measures)*

**<https://www.globalriskregulator.com/Subjects/Reporting-and-Governance/Post-Covid-19-new-normal-could-see-banks-having-to-rethink-resilience-measures>**

The logo for the Global Risk Regulator is a dark blue rounded square with a white border. Inside the square, the words "Global Risk Regulator" are written in a white, serif font, stacked vertically.

**Global  
Risk  
Regulator**

## Financial Times

Në periudhën e pamundësisë, çmimet e sigurimeve u ngritën kudo

Kërkesat për dëmshpërblim të klientëve pritet të tejkalojnë 100 miliardë dollarë, ndërsa tregjet e paqëndrueshme financiare janë me rezervat.

*(Insurance prices rise across the board as coronavirus hits)*

*Customer claims expected to exceed \$100bn, while volatile financial markets dent reserves.*

Oliver Ralph

<https://www.ft.com/content/9cd11711-6393-4810-993c-f1e905dc1f07>

Ndërtimi i sigurimeve për pandeminë tjetër

Industria e sigurimeve që tashmë është duke planifikuar për krizën tjetër - kërcërimi i një vale të dytë, mund të jetë vetëm pak muaj larg.

*(Designing insurance for the next pandemic)*

The industry is already planning for the next crisis - and the threat of a second wave means it might be only months away

Oliver Ralph, Anna Gross, Robert Armstrong

<https://www.ft.com/content/5001cbfa-c70d-4b3d-8425-72798bb5b542>

Situata e pandemisë i jep teknologjisë FinTech një mundësi për provuar se ja vlen


Platformat në internet aprovohen t'i bashkohen skemave të shpëtimit të qeverisë, e megjithatë dyshimet mbeten

*(Pandemic hands FinTech lenders a chance to prove their worth)*

*Online platforms win approval to join government rescue schemes, but doubts remain*

Nicholas Megaw, Robert Armstrong, Miles Kruppa

<https://www.ft.com/content/dcdd3016-797f-4d02-9d54-95a5b10cc2cd>



## Të kuptuarit e vlerave të qëndrueshmërisë dhe teknologjisë: sistemi financiar botëror pas Covid-19

*Diskutimi i Benoît Cœuré, Drejtues i Qendrës së Inovacionit, Bank for International Settlements, mbajtur në 17 prill 2020 në konferencën në webinar me temë "Ekonomia botërore u shndërrua".*

*Në fjalën e tij Benoît Cœuré thekson se mbetet ende për t'u parë se si do të shpaloset kriza pas Covid-19, as kur do të përfundojë. Ai thekson se valët e tronditjes që dërgon kjo krizë në ekonominë botërore sapo kanë filluar të ndjehen në ekonomitë në zhvillim dhe ato do të na kthehen. Në diskutim sugjerohen dy tema që formësojnë "ditët pas Covid-19": qëndrueshmëri dhe teknologji.*

*(Pjesa e parë - marrë me shkurtime dhe redaktime)*

### Vlera e qëndrueshmërisë në financat ndërkombëtare

Sistemi financiar global e përballoi tronditjen Covid-19 më mirë sesa u ndesh me Krizën e Madhe Financiare. Ky sukses i detyrohet më shumë veprimeve të guximshme të bankave qendrore. Duke e parë nga këndvështrimi edhe i retrospektivës, kjo përballje më e mirë i detyrohet shumë veprimeve të marra nga rregullatorët në dekadën pas Samitit të G20 të Pittsburgh.

Të nxitur nga rregullatorët, bankat kanë krijuar kapital dhe kanë ndërtuar mundësi për likuiditet, kanë përmirësuar praktikën e administrimit të rrezikut dhe kanë krijuar praktika të brendshme për koston sociale të marrjes së rrezikut. Si rezultat i këtyre përpjekjeve, bankat ishin mjaft më të përgatitur për të përballuar tronditjen e madhe në vitin 2020, sesa ishin në vitin 2008. Ata mund të përdorin mundësitë e likuiditetit (*buffer*) të cilët vite më parë nuk ekzistonin.


Por, me gjithë përparimin e bërë me politikën makro-prudenciale, ne kemi qenë më pak të përgatitur për ta bërë sistemin financiar global më elastik, të qëndrueshëm, si një sistem i ndërlidhur. Ne e dinim këtë fakt përpara Covid-19 dhe kjo kriza e konfirmoi atë.


Financat e bazuara tek tregu përbëjnë një hendek të identifikuar qartë në kornizën tonë makroprudenciale. Ne na mungojnë instrumentet për të zbutur lakoren ciklike në huadhëniet jobankare. Vitet e fundit, menaxherët e aseteve dhe fondeve kanë mbushur boshllëkun e krijuar nga tërheqja e bankave të mëdha sistemike. Sot, përballë strategjive të daljeve, ato mund të detyrohen të shesin asete dhe të forcojnë rregullimin e çmimeve.

Për më tej, javët e para të krizës Covid-19 nxorën në pah brishtësinë e mekanizmit të zbulimit të çmimeve në pjesë të mëdha të tregjeve tona të kapitalit. Likuiditeti i tregut është përkeqësuar më shpejt dhe më gjerësisht sesa gjatë Krizës së Madhe Financiare - kur tregjet e parave ishin më të prekura. Tregjet kryesore të financimit janë tensionuar në ekonomitë e përparuar.

Sistemi financiar global e përballoi tronditjen Covid-19 më mirë sesa u ndesh me Krizën e Madhe Financiare. Ky sukses i detyrohet më shumë veprimeve të guximshme të bankave qendrore.



—  —  
Fleksibiliteti i vendosur në rregulla mund të përdoret plotësisht, por edhe këto sisteme rregullash në vetvete duhet të mbrohen dhe mbështetja e publikut duhet të vijë e bashkëlidhur edhe me kushte, siç janë kufizimet për dividendët dhe shpërblimet.

—  —

Dhe kjo tendosje dhe ky tension po përhapet me shpejtësi edhe në tregjet në zhvillim, e rënduar edhe nga qasja e tyre e pabarabartë në fondet afatshkurtra të dollarit.

Si rezultat, në javët e kaluara, bankat qendrore u detyruan jo vetëm të adresonin mungesën e kërkesës agregate, siç bëjnë tradicionalisht, por u duhej të kryenin operacione speciale dhe delikate në një numër segmentesh të tregut për t'i bërë ato përsëri funksionale, duke ecur në terrene të paeksploruara.

Mbetet ende të gjykohet nëse ndërhyrja e kombinuar e bankave qendrore me qeverinë do të jetë e mjaftueshme për të shmangur krizën e likuiditetit, ne regjimin e *Solvency one* - e cila do të krijonte një mori çështjesh të reja. Ndërkohë ka mësim për bankat qendrore dhe rregullatorët në botën pas Covid-19 të cilat duhet të studiohen me kujdes. Përpjekjet për ta bërë sistemin financiar global më elastik nuk duhet të mungojnë, dhe madje ato duhet të rriten.

Fleksibiliteti i vendosur në rregulla mund të përdoret plotësisht, por edhe këto sisteme rregullash në vetvete duhet të mbrohen dhe mbështetja e publikut duhet të vijë e bashkëlidhur edhe me kushte, siç janë kufizimet për dividendët dhe shpërblimet. Dhe ne duhet të rinovojmë ndjenjën për të përmirësuar rezistencën e financave të bazuara në treg. Ne duhet të plotësojmë rrjetin global të sigurisë financiare si një çështje urgjente, duke u përqendruar në ekonomitë më të vogla dhe më të rrezikuara.

Unë e shoh shumë pozitiv propozimin për një rivendosje të *IMF Special Drawing Rights*: duke siguruar likuiditet për të gjithë anëtarët e FMN-së, të mëdha dhe të vogla, do të "merrte në të gjitha çarjet" e sistemit financiar global.

## **EIOPA**

[www.xprimm.com](http://www.xprimm.com)

Autoriteti Evropian për Sigurimet dhe Pensionet Private (EIOPA) konstaton në vlerësimin e tij më të fundit të rrezikut se pandemia COVID-19 ka sjellë një nivel të lartë pasigurie në tregun e sigurimeve në BE, duke prekur gjithashtu edhe industritë e tjera. Në raportin më të fundit të vlerësimit të riskut, EIOPA konstaton ndër të tjera se: “Është shtuar ekspozimi i industrisë evropiane të sigurimeve ndaj risqeve, ndërkohë që pandemia COVID-19 ka prekur jetët e qytetarëve evropiane, duke sjellë probleme në të gjithë sektorët financiarë dhe aktivitetet ekonomike.

Të dhënat nga tregu i sigurimeve në BE flasin për një rënie dyshifrore, që ka prekur siguruesit si në asete, ashtu edhe në detyrime.” Për të ruajtur kapitalet brenda sistemit, në fillim të muajit prill, EIOPA u sugjeroi rregullatorëve në Bashkimin Evropian t’u rekomandonin shoqërive të sigurimit ndjekjen e politikave të kujdesshme në shpërndarjen e dividendit.

## **Evropa Qendrore dhe Lindore**

[www.xprimm.com](http://www.xprimm.com)

Tregu i sigurimeve në Evropën Qendrore dhe Lindore e mbylli vitin 2019 me një rritje prej 5.85% të primeve të shkruara bruto, duke arritur në 39.1 miliardë euro. Referuar primeve të shkruara bruto, Polonia mbetet tregu më i madh i sigurimeve në Evropën Qendrore dhe Lindore, ndjekur nga Republika Çeke, Hungaria, Sllovenia dhe Rumania. Të pesta këto vende së bashku përbëjnë 76% të primeve të shkruara bruto në rajon. Sigurimi motorik ka patur rolin kryesor në rritjen e primeve të shkruara bruto në tregun e sigurimeve të Evropës Qendrore dhe Lindore dhe në veçanti sigurimi MTPL.

## **Serbia**

[www.xprimm.com](http://www.xprimm.com)

Sipas të dhënave të publikuara nga Banka Kombëtare e Serbisë, tregu i sigurimeve e mbylli vitin 2019 me një rritje prej 7.5% të primeve të shkruara bruto, duke siguruar 107.5 miliardë RSD (dinari, monedha vendase) ose 914 milionë euro. Sigurimi i Jo-Jetës u rrit me 8.2%, duke arritur në 82.4 miliardë dinarë, ndërsa sigurimi i Jetës u rrit me 5.4%, duke arritur në 25.1 miliardë dinarë. Siguruesit në Serbi paguan 52.8 miliardë dinarë, ose 449 milionë euro dëme përgjatë vitit 2019.



---

---

## AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE

Për informacion të mëtejshëm  
ju lutemi na kontaktoni:

Rr. "Dora D'Istria", Nr. 10 , P.O.Box 8363, Tiranë  
Tel: +355 42 251 355/6 | Fax: +355 42 250 686  
[amf@amf.gov.al](mailto:amf@amf.gov.al) | [www.amf.gov.al](http://www.amf.gov.al)